



TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

- Emri i NSH-së:** Gradjevinar, Shtërpcë, Fi. – 33/96, ("Ndërmarrja")
- Emri i Ndërmarrjes së Re:** **Ndërmarrja e Re apartamentet në Shtëpinë e Bardhë Sh.P.K.**
("Ndërmarrja e Re")
- Ndërmarrja e Re e ofruar për shitje përfshin vetëm asetin e përshkruar si më poshtë. Asetet e ngelura të Ndërmarrjes nuk ofrohen për shitje, ato do të privatizohen veçmas.
- Vendndodhja:** Prona që ofrohet për shitje në këtë tender ndodhet në Shtëpinë e Bardhë, rruga e Nerodimes, Ferizaj.
- Biznesi/Spektori:** Ndërtimtari.
- Prodhimet:** Ndërmarrja e Re ofron mundësin e kompletimit dhe dhënies me qira të apartamenteve në rrugën e Nerodimes, në qendër të Ferizajt. Kjo ofron një mundësi tërheqëse për zhvillim të ndërmarrjeve për patundshmëri.
- Tregu:** Qyteti i Ferizajt është qendër për tregti dhe shërbime të sektorit ekonomik. Janë paraqitur kërkesa të konsiderueshme për hapësirë banesore në Ferizaj dhe kjo ofertë ofron mundësi të shkëlqyeshme për zhvillim të biznesit.
- Konkurrenca:** Apartamentet, subjekt i këtij tenderi përbëhen nga një ndërtesë impesive dhe paraqesin një ofertë atraktive. Në të njëjtën kohë ka edhe një numër të ndërtimeve të reja banesore në zhvillim që janë duke u ndërtuar në qendër të qytetit.
- Punonjësit:** Nuk ka punëtorë të NSh-se.
- Ndërtesat dhe tokat:** Kjo ofertë përfshinë tërë katin më banesa me sipërfaqe përafërsisht prej 622 m². Të gjitha banesat gjenden në katin e tretë të Shtëpisë së Bardhë në qendër të Ferizajt, dhe të gatshme për përshtatje dhe finalizim. Sipërfaqet e brendshme janë përafërsisht me sa vijon:
- 1) Apartamenti 1 me sipërfaqe përafërsisht prej 79 m²
 - 2) Apartamenti 2 me sipërfaqe përafërsisht prej 48 m²
 - 3) Apartamenti 3 me sipërfaqe përafërsisht prej 112 m²
 - 4) Apartamenti 4 me sipërfaqe përafërsisht prej 45 m²
 - 5) Apartamenti 5 me sipërfaqe përafërsisht prej 67 m²
 - 6) Apartamenti 6 me sipërfaqe përafërsisht prej 59 m²
 - 7) Apartamenti 7 me sipërfaqe përafërsisht prej 52 m²
- Sipërfaqja e përgjithshme e apartamenteve është rreth 462 m². Secilit apartament i takon një depo me rreth 4 m². Të gjitha apartamentet kanë ballkone me sipërfaqe rreth prej 8 m² dhe disa kanë qasje direkt në ballkonin e përbashkët me sipërfaqe rreth prej 75 m².



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Detyrimet që do të barten:

- (1) Detyrimet neto të NSh-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobat, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (2) Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose
- (4) pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (5) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
 - a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
 - b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-së.

Foto e Ndërmarrjes së Re

Ndërtesa e Shtëpisë së Bardhë



Informatat:

Departamenti i Shitjes
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255
Fax: +381 (0) 38 500 400
www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit:

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr: Ilir Konushevci Nr:8
10000 Prishtinë, Kosovë

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencialë inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencialë këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: